



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/571

Datë: 26.12.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 40 paragrafi 2 pika a, c, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), nenit 2,8 dhe 9 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.27/03 qershor 2008"), nenit 7 të Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.88/25 nëntor 2010), të dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr.04/L-100, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e paluajtshme, nenit 12 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ("Gazeta zyrtare e republikës së Kosovës nr.2/15 shkurt 2018), nenit 19 paragrafi 7 pika e, nenit 38, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, ftesës për debat publik nr.04/153 datë:11.12.2018, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -XIII- të mbajtur me datë:21.12.2018 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME
PËR VITIN 2019

1. Miratohet Rregullorja për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për Komunën e Malishevës për vitin 2019, e propozuar nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet dhe zyrës për tatimin në pronë.
3. Rregullorja hyn në fuqi me 1 Janar të vitit 2019.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

MAPL-së

Drejtorive të KK-së

Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

